



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 106/2014**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIN E  
PAGAVE TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TE DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe në nenin 37, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Miratohet struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

II. Struktura e KDIMDP-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Organika e KDIMDP-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Ilir META**

Miratuar në datën 18.12.2014